

BANKA POPULLORE E REPUBLIKËS SË MAQEDONISË

DREJTORIA E POLITIKËS MONETARE DHE E HULUMTIMIT



Treguesit më të rinj makroekonomikë
Rishikimi i gjendjes aktuale

Mars, 2022

Treguesit më të rinj makroekonomikë

Rishikimi i gjendjes aktuale – ndikimi ndaj politikës monetare

Rishikimi i gjendjes aktuale synon të japë një pasqyrë të të dhënave më të fundit makroekonomike (dhjetor 2021 – shkurt 2022) dhe një krahasim me projeksionet më të fundit makroekonomike (tetor 2021). Kjo do të vërtetojë se si gjendja aktuale e ekonomisë korrespondon me lëvizjet e pritshme të variablave në ciklin e fundit të projeksioneve. Rishikimi është përqendruar në ndryshimet e supozimeve dhe të realizimeve të jashtme në variablat e brendshme dhe si janë pasqyruar këto ndryshime në mjedisin e drejtimit të politikës monetare.

Me materializimin e rreziqeve gjeopolitike dhe fillimin e konfliktit ushtarak midis Rusisë dhe Ukrainës, si dhe sanksioneve ekonomike të vendosura kundër Rusisë, vlerësimet për rritjen e ardhshme globale po bëhen më pak të favorshme. Përshkallëzimi i konfliktit ruso-ukrainas shkaktoi një rritje të fortë dhe ndryshueshmëri të lartë në çmimet të produkteve parësore energjetike dhe joenergjetike, pasi një nga eksportuesit kryesorë botërorë të këtyre produkteve, rriti paqëndrueshmërinë e tregjeve financiare, si dhe rrezikun e destabilizimit të rrjedhave tregtare globale dhe të uljes së besimit të subjekteve ekonomike, me vlerësime të efekteve të pafavorshme kryesisht në inflacionin global, por edhe në rimëkëmbjen e ekonomisë globale. Prandaj, aktualisht *rreziku kryesor* është kohëzgjatja dhe ashpërsia ushtarake e këtij konflikti dhe efektet e sanksioneve aktuale dhe ndoshta shtesë kundër Rusisë dhe vendeve të tjera mbështetëse, si dhe nga Rusia ndaj vendeve të tjera. Nga rreziqet e tjera, ecuria e ardhshme e pandemisë mbetet një faktor rreziku i rëndësishëm nga aspekti i shfaqjes së llojeve të reja të virusit, të cilat do të zgjasnin pandeminë dhe do të çonin në ndërprerje të reja të zinxhirëve të furnizimit global. Gjithashtu, shtrëngimi i mundshëm më i shpejtë i politikës monetare në vendet e zhvilluara mund të ketë efekte negative në stabilitetin financiar dhe pozicionet fiskale të vendeve me rritje të shpejtë me borxhe të larta. Në lidhje me **lëvizjet ekonomike në Eurozonë**, si partneri ynë kryesor tregtar, treguesit e anketës së subjekteve ekonomike për muajin shkurt janë më të favorshëm krahasuar me muajin paraardhës, kryesisht për shkak të rritjes në sektorin e shërbimeve dhe të tregtisë me pakicë, si rezultat i lehtësimit të masave kufizuese, duke treguar një rritje të qëndrueshme vjetore. Në mënyrë të ngjashme, edhe anketat hulumtuese në Gjermani, partnerin tonë të vetëm më të rëndësishëm tregtar, tregojnë një përmirësim të aktivitetit në shkurt dhe vlerësime të rritjes së përshpejtuar vjetore ekonomike. Duhet theksuar se këto anketa hulumtuese janë bërë para përshkallëzimit të konfliktit ushtarak në Ukrainë dhe vendosjes së sanksioneve kundër Rusisë nga një numër i madh vendesh dhe kompanish ndërkombëtare. Megjithatë, disa vlerësime fillestare të efekteve negative të këtij konflikti ushtarak u përfshinë në projeksionet e marsit të BQE-së për rritjen ekonomike dhe inflacionin. Kështu, rritja e PBB-së në vitin 2022 u rishikua në rënie dhe pritet të jetë 3,7%, ndërsa për vitin 2023 dhe 2024, vlerësimet janë thujtë të njëjta, pra rritje prej 2,8% dhe 1,6% më 2023 dhe 2024 në mënyrë përkatëse¹. Tregu i punës në Eurozonë vazhdoi të ketë lëvizje të mira në janar, me shkallën e papunësisë që ra në një nivel historikisht të ulët prej 6,8%² (7,1% në tremujorin e katërt të vitit 2021). Sa i përket inflacionit në Eurozonë, të dhënat e përlogaritura për shkurtin tregojnë përshpejtimin e tij të mëtejshëm, duke arritur një nivel historik të lartë prej 5,8% me bazë vjetore (5,1% në janar), me rritje të përshpejtuar në të gjithë komponentët, veçanërisht në atë energjetik. Në të njëjtën kohë, arritje të tilla dhe pritshmëri më të larta për çmimet e naftës dhe të ushqimeve në bursat botërore pasqyrohen edhe në një rishikim në rritje të shkallës së projektuar të inflacionit nga BQE-ja. Kështu, sipas projeksioneve të marsit, shkalla e inflacionit më 2022 pritet të arrijë mesatarisht në 5,1%, përpara se të ngadalësohet në 2,1% dhe 1,9% më 2022 dhe 2023 në mënyrë përkatëse³. Krahas skenarit bazë, për shkak të pasigurisë së madhe lidhur me efektin e konfliktit

¹ Në dhjetor të vitit 2021, rritja e PBB-së prej 4,2%, 2,9% dhe 1,6% ishte projektuar në mënyrë përkatëse për vitin 2022, 2023 dhe 2024.

² I referohet periudhës nga prilli i vitit 1998, kur publikohen të dhënat mujore për shkallën e papunësisë në Eurozonë, dhe për herë të parë shkalla e papunësisë është nën 7%.

³ Në dhjetor të vitit 2021, shkalla e inflacionit ishte projektuar në 3,2% më 2022 dhe 1,8% më 2023 dhe 2024.

ushtarak në Ukrainë, janë zhvilluar edhe dy skenarë alternativë⁴. Për më tepër, në mbledhjen e rregullt të marsit, BQE-ja nuk ndryshoi normat e interesit, por njoftoi rritjen graduale të tyre, pas përfundimit të programit të lehtësimit sasior (APP), i cili pritet të shterohet në fund të tremujorit të tretë⁵. Prandaj, sipas vlerësimeve të fundit, më 2022, **norma e huaj e interesit EURIBOR** me maturim njëmuor, do të jetë mesatarisht në të njëjtin nivel me projeksionin e tetorit, ndërsa për vitin 2023 është bërë një korrigjim më domethënës në rritje, në përputhje me pritshmëritë e tregut për një normalizim gradual të politikës monetare të BQE-së, duke filluar nga fundi i vitit.

Nga këndvështrimi i treguesve të veçantë sasiorë për mjedisin e jashtëm, që janë të rëndësishme për ekonominë maqedonase, kërkesa e huaj efektive për vitin 2021 realizoi rritje prej 4,4%, më e lartë se projeksionet e tetorit. Për dy vitet e ardhshme, rishikimet janë në një drejtim tjetër, me ç'rast vlerësimi për vitin 2022 është rishikuar në rënie, kurse për vitin 2023 në rritje. Nga ana tjetër, në rastin e **inflacionit të huaj efektiv**, janë bërë korrigjime në rritje të vlerësimeve për dy vitet e projeksioneve, veçanërisht për vitin 2022. Projeksionet e reja për **kursin valutor EUR/USD** tregojnë një rishikim më të theksuar në rritje të vlerës së dollarit amerikan në vitin 2022 dhe një rishikim të vogël në rënie në vitin 2023. **Vlerësimet e fundit për çmimet e produkteve parësore në bursat botërore janë rishikuar në rritje për vitin 2022, ndërsa për vitin 2023 korrigjimet janë në kahe rënëse krahasuar me vlerësimet e tetorit.** Kështu, më 2022 pritet një rritje dukshëm më e lartë e çmimeve të produkteve parësore, ndërsa më 2023 pritet të ketë një rënie më të fortë të çmimeve. Megjithatë, lëvizjet dhe vlerësimet e çmimeve të produkteve parësore janë jashtëzakonisht të ndryshueshme dhe aktualisht janë nën ndikimin e fuqishëm të zhvillimeve në lidhje me konfliktin ushtarak ruso-ukrainas, që krijon pasiguri të madhe për dinamikën e ardhshme të tyre dhe efektet në ekonominë vendase, veçanërisht në afat të shkurtër.

Krahasimi i treguesve të fundit makroekonomikë të ekonomisë vendase me dinamikën e tyre të projektuar brenda ciklit të projeksioneve të tetorit, tregon për rënie të caktuara në segmente të caktuara të ekonomisë. Sipas të dhënave të vlerësuara të publikuara të PBB-së, në tremujorin e katërt të vitit 2021, PBB-ja reale shënoi rritje prej 2,3% në bazë vjetore (rritje prej 3% në tremujorin paraardhës). Me këto realizime, rritja e mëtejshme e ekonomisë vendase vazhdoi, por me ritme më të ngadalta, në kuadër të përhapjes së valës së pestë të pandemisë së shoqëruar me llojin "omicron" të KOVID-19, ndërprerje të zinxhirëve të furnizimit global dhe shfaqja e efekteve të para të ndërprerjeve të tregut të energjisë. Duke parë të gjithë vitin 2021, ekonomia shënon një rritje reale prej 4%, që është brenda pritshmërive nga projeksioni i tetorit (3,9%). Analizuar sipas komponentëve, kërkesa vendase ka një kontribut pozitiv në rritje, në kushtet e rritjes në të gjitha kategoritë (investimet bruto, konsumi personal dhe konsumi publik). Nga ana tjetër, komponenti i eksportit neto shënoi një kontribut negativ, në kushtet e rritjes dukshëm më të fortë të importeve, krahasuar me rritjen e eksporteve. Të dhënat në dispozicion me frekuencë të lartë për tremujorin e parë të vitit 2022 janë të pjesshme dhe të pamjaftueshme për të kuptuar gjendjen në tërësi. Përshkallëzimi ushtarak midis Rusisë dhe Ukrainës shkaktoi vështirësi shtesë për të kuptuar gjendjen e ekonomisë, me efekte të pafavorshme edhe në ekonominë globale. Të dhënat e janarit tregojnë rritje të mëtejshme reale vjetore të qarkullimit në totalin e tregtisë, si dhe rritje të lehtë të prodhimit industrial në bazë vjetore, pas rënies në tremujorin e mëparshëm. **Sa u përket ndryshimeve në çmimet e konsumit, në shkurt të vitit 2022 u arrit një shkallë vjetore e inflacionit prej 7,6%, e cila është një realizim më i lartë, krahasuar me projeksionet e fundit.** Dinamika vjetore e inflacionit është kryesisht pasqyrim i rritjes së çmimeve të energjisë dhe

⁴ Në skenarin e parë "të pafavorshëm", supozohen sanksione më të forta kundër Rusisë dhe një ndërprerje e përkohshme e furnizimit me gaz nga Rusia që do të kompensohet nga burime të tjera, ndërkaq tendosjet gjeopolitike do të zgjasin më shumë se skenari bazë, që në përgjithësi do të shkaktojë ndërprerjen e zinxhirëve të furnizimit, rritjen e shpenzimeve të energjisë, uljen e prodhimit, ndërprerjen e tregjeve financiare dhe rritjen e pasigurisë së zgjatur, e cila do të çojë në një PBB më të ulët për 1,2 p.p. dhe inflacionin më të lartë për 0,8 p.p. në vitin 2022. Në vitin 2023, efektet në rritjen ekonomike dhe inflacionin do të jenë minimale, krahasuar me skenarin bazë. Në skenarin e dytë "ekstrem", supozohet gjithashtu një reagim më i fortë i çmimeve të karburanteve ndaj uljes së ofertës, një ndërprerje më e fortë e tregjeve financiare dhe një efekt më i madh i çmimeve të karburanteve në çmimet e tjera, që do të çojë në uljen e rritjes ekonomike për 1,4 p.p. dhe inflacion më të lartë për 2 p.p. në vitin 2022 në raport me skenarin bazë. Gjatë këtij skenari, një rënie e rritjes (për 0,5 p.p.) dhe inflacion më i lartë (për 0,6 p.p.) pritet edhe në vitin 2023.

⁵ Përveç kësaj, në mes të pasigurisë së shtuar nga konflikti ushtarak ruso-ukrainas, u mor një vendim për të zgjatur linjat e repove të likuiditetit valutor të paracaktuara për bankat qendrore jashtë zonës së euros (EUREP) deri më 15 janar 2023.

të produkteve ushqimore, si rezultat i rritjes së lartë të çmimeve të importit, me një rritje më mesatare të inflacionit bazë. Trysni të e çmimeve vazhdojnë të burojnë kryesisht nga faktorët e ofertës që lidhen me ndryshimet e çmimeve në tregjet globale të shoqëruara me ndërprerje në tregun e energjisë dhe ndërprerje në zinxhirët e furnizimit global. Inflacioni i realizuar në periudhën janar-shkurt 2022 është mbi projeksionin dhe pritshmëritë nga dinamika e ardhshme e çmimeve të importeve janë korrigjuar në rritje, pra rreziqet e projeksionit të inflacionit janë në rritje. Në të njëjtën kohë, në kushtet e luhatjeve të ndjeshme të lëvizjes së çmimeve botërore të produkteve parësore, edhe në baza ditore, të shkaktuara nga lufta në Ukrainë dhe sanksionet e vendosura ndaj Rusisë nga shumica e vendeve të botës, pasiguria në lidhje me lëvizjet e ardhshme të çmimeve janë jashtëzakonisht të larta.

Niveli i rezervave valutore dhe analiza e treguesve të mjaftueshmërisë së tyre tregon që vazhdojnë të jenë në zonën e sigurt. Të dhënat në dispozicion për janarin 2022 tregojnë një deficit tregtar që është disi më i lartë se sa pritej për tremujorin e parë të vitit, por periudha e vlerësimit është shumë e shkurtër për të nxjerrë përfundime më të besueshme. Të dhënat e operacioneve valutore të shkurtit 2022 tregojnë flukse hyrëse neto të realizuara nga transferet private, të cilat aktualisht janë pak më të ulëta se sa pritej për tremujorin e parë të vitit 2022. Realizimet në bilancin e pagesave për të gjithë vitin 2021 tregojnë një deficit më të ulët të llogarisë rrjedhëse, krahasuar me projeksionin e tetorit, në një pozicion dukshëm më të mirë të llogarisë financiare së bashku me hyrjet neto nga SPV.

Sa u përket lëvizjeve në sektorin monetar, të dhënat e janarit të vitit 2022 tregojnë një rënie të zakonshme mujore të **totalit të depozitave** prej 0,8% (rritje mujore prej 2,5% në dhjetor të vitit 2021), e cila është kryesisht rezultat i depozitave të korporatave, me një gjendje pothuajse të pandryshuar të depozitave të amvisërive. Nga këndvështrimi valutor, ndryshimi mujor i gjithsej depozitave është rezultat i depozitave në denarë (më së shumti si rezultat i rënies së parave depozituese), me rritje të moderuar të depozitave në valutë. Në bazë vjetore, totali i depozitave u rrit për 7,2% në janar, që është mbi rritjen e projektuar vjetore (prej 6,9%) për tremujorin e parë të vitit 2022. **Totali i kredive** në janar të vitit 2022 mbeti i pandryshuar në bazë mujore (rritje prej 1,7% në dhjetor të vitit 2021), pa ndryshime nga këndvështrimi sektoral. Sipas strukturës valutore, kreditë në valutë shënuan një rënie të vogël mujore, ndërsa kreditë në valutë vendase shënuan një ndryshim minimal pozitiv. Në bazë vjetore, rritja e totalit të kredive vazhdon të përshpejtohet dhe në janar është 8,4%, me rritje të projektuar për tremujorin e parë të vitit 2022 prej 7,1%, në përputhje me projeksionin e tetorit.

Në Buxhetin e Republikës së Maqedonisë së Veriut në janar të vitit 2022 është realizuar deficit prej 3.430 milionë denarë. Deficiti buxhetor financohet më së shumti duke shfrytëzuar depozitat e shtetit në Bankën Popullore dhe me huamarrjen e shtetit në tregun vendas. Deficiti buxhetor i realizuar në janar përfaqëson 10,2% të deficitit të parashikuar nga buxheti për vitin 2022.

Treguesit e fundit makroekonomikë dhe vlerësimet e fundit tregojnë rritje të rreziqeve në segmente të caktuara të ekonomisë dhe një mjedis të pasigurt për zbatimin e politikës monetare. Rezervat valutore mbahen në nivelin e duhur dhe në zonën e sigurt dhe trysni të e çmimeve nga kriza energjetike janë faktori kryesor për realizimet e tregut valutor në shkurt. Rritja e realizuar e prodhimit të brendshëm bruto në vitin 2021 është në përputhje me projeksionet, por sipas zhvillimeve më të fundit gjeopolitike, perspektiva e rritjes, si për tremujorin e parë, ashtu edhe për të gjithë vitin 2022, shoqërohet me pasiguri të madhe dhe rënie të mundshme të rreziqeve. Në fakt, të dhënat në dispozicion, aktualisht, me frekuencë të lartë për aktivitetin ekonomik për tremujorin e parë janë të favorshme, por vazhdojnë të jenë të pamjaftueshme për të dhënë një vlerësim më të saktë, ndërsa vështirësitë shtesë për të kuptuar situatën janë shkaktuar nga përshkallëzimi ushtarak midis Rusisë dhe Ukrainës, si dhe vendosja e sanksioneve drejt dhe nga Rusia, të cilat mund të kenë efekte negative edhe në ekonominë globale, në varësi të kohëzgjatjes. Arritjet inflacioniste me shkurtin vazhdojnë të jenë mbi të projektuarat, nën tryshninë e rritjes së çmimeve të importit të karburanteve dhe të ushqimeve, kurse lëvizja e tyre aktuale është jashtëzakonisht e


ndryshueshme dhe e pasigurt dhe nën ndikimin e zhvillimeve ushtarake. Në sektorin monetar, lëvizjet vazhdojnë të jenë solide dhe rritja vjetore e depozitave dhe e kredive në janar të 2022 është mbi atë të projektuar për tremujorin e parë të vitit 2022, sipas projekcionit të tetorit.

Rritja e aktivitetit ekonomik për 4% më 2021

Në vitin 2021, PBB-ja reale u rrit për 4%, pas një rënie të mprehtë prej 6,1% më 2020, lidhur me krizën shëndetësore dhe ekonomike të shkaktuar nga pandemia Kovid-19. Imunizimi masiv në vend, përshtatja graduale e sjelljeve dhe e prirjeve të subjekteve në kushtet e pandemisë, hapja e ekonomive dhe zbatimi i masave të synuara dhe më pak kufizuese për përballimin e pandemisë, kontribuan në një rimëkëmbje graduale të ekonomisë, kryesisht në sektorin e shërbimeve. Rritja e konsumit personal dhe e investimeve, e mbështetur nga rritja e të ardhurave në dispozicion dhe forcimi i aktivitetit kreditues të bankave, janë nxitësit kryesorë të rritjes së kërkesës vendase. Kjo, së bashku me rimëkëmbjen e fortë të eksporteve, rriti edhe importet, prandaj edhe eksportet neto në vitin 2021 kishin një kontribut negativ. Rimëkëmbja është në përputhje me pritshmëritë dhe përfaqëson vetëm një kompensim të pjesshëm të humbjeve nga pandemia, e cila kishte një ndikim të fortë në kërkesën vendase dhe që nuk e ka arritur ende nivelin e parakrizës.


Селектирани макроекономски показатели ^{/1}					2020					2021												2022							
	2016	2017	2018	2019	Кв.1	Кв.2	Кв.3	Кв.4	2020	јан.	фев.	март	Кв.1	апр.	мај	јун.	Кв.2	јул.	авг.	сеп.	Кв.3	окт.	ное.	дек.	Кв.4	2021	јан.	фев.	
I. Реален сектор индикатори																													
Бруто домашен производ (годишна реален раст) ^{/2}	2,8	1,1	2,9	3,9	-1,3	-16,4	-5,9	-0,8	-6,1				-1,8				13,4				3,0				2,3	4,0			
Индустриско производство ^{/3}																													
стапка на промена (годишна)	3,4	0,2	5,4	3,7	-3,7	-25,0	-7,5	-2,3	-9,5	-13,5	-12,2	7,6	-6,1	46,1	16,5	9,5	22,2	-0,6	-1,4	-8,0	-3,5	-6,5	4,7	-4,9	-2,3	1,4	0,7		
кумулативна просечна стапка	3,4	0,2	5,4	3,7	-3,7	-14,6	-12,1	-9,5	-9,5	-13,5	-12,8	-6,1	-6,1	3,7	6,0	6,6	6,6	5,4	4,5	2,9	2,9	1,8	2,1	1,4	1,4	1,4	0,7		
Инфлација ^{/4}																													
ЦПИ Инфлација (годишна) ^{/5}	-0,2	2,4	0,9	0,4	0,6	0,5	1,5	2,2	2,3	1,9	1,9	2,1	2,0	2,7	3,0	2,7	2,8	3,4	3,6	3,7	3,5	4,1	4,8	4,9	4,6	4,9	6,7	7,6	
ЦПИ Инфлација (кумулативна просечна)	-0,2	1,4	1,5	0,8	0,6	0,5	0,9	1,2	1,2	1,9	1,9	2,0	2,0	2,2	2,3	2,4	2,4	2,5	2,7	2,8	2,8	2,9	3,1	3,2	3,2	3,2	6,7	7,1	
Базична инфлација (кумулативна просечна)	1,3	2,3	1,5	0,5	0,7	0,6	0,7	0,9	0,9	1,8	1,7	1,6	1,6	1,6	1,7	1,8	1,8	2,0	2,1	2,2	2,2	2,2	2,3	2,4	2,4	2,4	3,2	3,7	
Базична инфлација (годишна) ^{/5}	1,0	2,8	1,4	-0,3	0,7	0,5	0,8	1,6	1,9	1,8	1,6	1,5	1,6	1,7	1,8	2,4	2,0	3,0	2,8	2,9	2,9	2,9	3,1	2,9	3,0	2,9	3,2	4,3	
Работна сила																													
Стапка на невработеност	23,7	22,4	20,7	17,3	16,2	16,7	16,5	16,1	16,4				16,0				15,9				15,7				15,2	15,7			
II. Фискален сектор индикатори																													
(Централен Буџет и Буџети на фондови)																													
Вкупни буџетски приходи	169.356	179.673	188.505	203.822	46.484	40.923	48.585	53.562	189.554	14.810	16.435	17.673	48.918	19.292	15.735	17.464	52.491	20.205	17.167	19.347	56.719	20.063	19.128	21.186	60.377	218.505	16.768		
Вкупни буџетски расходи	185.407	196.561	200.071	217.445	53.895	59.458	58.511	71.557	243.421	17.520	19.189	19.106	55.815	19.263	20.767	21.243	61.273	23.353	22.525	19.734	65.612	19.039	25.597	29.952	74.588	257.288	20.198		
Буџетско салдо (готовинска основа)	-16.051	-16.888	-11.566	-13.623	-7.411	-18.535	-9.926	-17.995	-53.867	-2.710	-2.754	-1.433	-6.897	29	-5.032	-3.779	-8.782	-3.148	-5.358	-387	-8.893	1.024	-6.469	-8.766	-14.211	-38.783	-3.430		
Буџетско салдо (% од БДП) ^{/1}	-2,7	-2,7	-1,8	-2,0	-1,1	-2,8	-1,5	-2,7	-8,2	-0,4	-0,4	-0,2	-1,0	0,0	-0,7	-0,5	-1,2	-0,4	-0,7	-0,1	-1,2	0,1	-0,9	-1,2	-2,0	-5,4	-0,4		
III. Финансиски индикатори ^{/6}																													
Парична маса (M4), годишна стапка на раст	6,2	5,1	11,8	9,3	8,9	9,8	6,9	6,9	6,9	7,7	8,2	7,9	7,9	7,1	7,0	6,7	6,7	7,1	9,6	8,2	8,2	7,8	7,6	7,0	7,0	7,0	6,5		
Вкупни кредити, годишна стапка на раст																													
Вкупни кредити на население	-0,1	5,4	7,3	6,0	5,8	6,6	7,3	4,7	4,7	4,6	4,4	5,2	5,2	5,7	5,6	5,1	5,1	5,2	6,4	6,3	6,3	6,7	7,7	8,3	8,3	8,3	8,4		
Вкупни кредити на претпријатија	7,0	9,2	10,3	10,5	10,1	8,8	9,5	8,0	8,0	7,4	7,1	8,1	8,1	8,9	8,8	8,7	8,7	8,0	7,9	7,5	7,5	7,3	7,7	7,8	7,8	7,8	7,8		
Вкупни депозити (со депозитни пари), годишна стапка на раст ^{/7}	-5,3	2,3	4,5	1,9	1,8	4,6	5,2	1,1	1,1	1,6	1,4	2,1	2,1	2,3	2,1	1,2	1,2	2,0	4,5	4,8	4,8	5,6	7,4	8,7	8,7	8,7	9,0		
Вкупни депозити на население	6,1	5,0	12,1	9,0	7,9	8,4	5,4	5,7	5,7	6,1	6,9	7,3	7,3	6,8	7,1	6,7	6,7	6,8	9,9	8,2	8,2	7,9	7,9	7,5	7,5	7,5	7,2		
Вкупни депозити на претпријатија	2,5	6,1	9,5	7,9	8,6	8,7	6,1	4,6	4,6	4,7	5,2	5,2	5,2	4,7	4,8	4,2	4,2	4,3	7,4	6,9	6,9	7,2	7,1	7,1	7,1	7,1	6,8		
Каматни стапки ^{/8}	13,4	2,1	9,5	14,6	12,5	11,2	8,0	10,1	10,1	12,0	13,7	12,9	12,9	14,3	16,0	16,7	16,7	17,1	20,2	15,6	15,6	13,9	13,7	11,6	11,6	11,6	11,5		
Каматни стапки ^{/8}																													
Каматна стапка на БЗ (крај на месец/квартал/година)	3,75	3,25	2,50	2,25	1,75	1,50	1,50	1,50	1,50	1,50	1,50	1,25	1,25	1,25	1,25	1,25	1,25	1,25	1,25	1,25	1,25	1,25	1,25	1,25	1,25	1,25	1,25		
Активни каматни стапки																													
денарски	7,0	6,6	6,1	5,6	5,3	5,3	5,1	5,1	5,2	5,0	5,0	5,0	5,0	5,0	4,9	4,9	4,9	4,8	4,8	4,8	4,8	4,8	4,7	4,7	4,7	4,9	4,6		
девизни (агрегатна, за девизни и денарски со девизна клаузула)	5,7	5,3	4,9	4,6	4,4	4,3	4,3	4,2	4,3	4,2	4,2	4,1	4,2	4,1	4,1	4,1	4,1	4,1	4,1	4,1	4,1	4,1	4,1	4,0	4,1	4,1	4,0		
Пасивни каматни стапки																													
денарски	2,5	2,2	2,0	1,9	1,6	1,5	1,4	1,4	1,5	1,3	1,3	1,3	1,3	1,3	1,2	1,2	1,2	1,2	1,1	1,1	1,1	1,1	1,1	1,1	1,1	1,2	1,0		
девизни (агрегатна, за девизни и денарски со девизна клаузула)	1,0	0,9	0,8	0,8	0,7	0,6	0,6	0,6	0,6	0,5	0,5	0,5	0,5	0,5	0,5	0,5	0,5	0,5	0,5	0,5	0,5	0,5	0,5	0,5	0,5	0,5	0,4		
IV. Надворешен сектор индикатори																													
Биланс на тековна сметка (во милиони ЕУР)	-275,5	-102,9	-7,12	-368,3	-155,68	-90,0	-50,6	-69,9	-366,2	29,6	-67,4	-15,1	-53,0	-112,9	-5,4	3,0	-115,3	90,8	-7,6	15,8	99,1	-62,6	-109,3	-174,6	-346,5	-415,7			
Биланс на тековна сметка (% од БДП)	-2,9	-1,0	-0,07	-3,3	-1,45	-0,8	-0,5	-0,6	-3,4	0,3	-0,6	-0,1	-0,5	-1,0	0,0	0,0	-1,0	0,8	-0,1	0,1	0,8	-0,5	-0,9	-1,5	-3,0	-3,5			
Трговски биланс (во милиони ЕУР) ^{/9}	-1.786,2	-1.816,2	-1.811,4	-2.007,7	-511,04	-384,3	-390,6	-530,7	-1.816,6	-96,4	-201,4	-231,9	-529,63	-274,6	-206,6	-223,9	-705,1	-218,1	-238,3	-161,2	-617,6	-248,3	-263,8	-351,2	-863,3	-2.715,7	-260,6		
Трговски биланс (% од БДП)	-18,0	-18,1	-16,9	-17,9	-4,75	-3,6	-3,6	-4,9	-16,7	-0,8	-1,7	-2,0	-4,5	-2,3	-1,8	-1,9	-6,0	-1,9	-2,0	-1,4	-5,3	-2,1	-2,2	-3,0	-7,4	-23,1	-2,1		
Увоз (во милиони ЕУР)	-6.176,5	-6.834,9	-7676,3	-8441,0	#####	-1.426,9	-1.996,8	-2.252,0	-7.594,5	-623,7	-746,6	-820,5	-2.190,8	-891,6	-753,7	-807,6	-2.452,9	-805,2	-804,4	-725,7	-2.335,3	-837,2	-878,1	-943,9	-2.659,3	-9.638,3	-806,6		
Извоз (во милиони ЕУР)	4.390,3	5.018,7	5872,4	6433,3	1.407,72	1.042,6	1.606,2	1.721,4	5.777,9	527,3	545,2	588,6	1.661,2	617,0	547,1	583,8	1.747,8	587,1	566,2	564,5	1.717,7	588,9	614,3	592,7	1.795,9	6.922,6	546,0		
стапка на раст на увозот (годишна)	6,5	10,7	12,3	10,0	-3,60	-31,9	-3,4	-1,4	-10,0	5,5	3,7	35,1	14,2	138,5	65,5	35,1	71,9	12,3	33,3	7,3	17,0	9,5	26,3	19,1	18,1	26,9	29,3		
стапка на раст на извозот (годишна)	7,4	14,3	17,9	9,6	-8,25	-35,9	-1,7	5,1	-10,0	15,4	4,9	36,6	18,0	192,0	61,2	18,7	67,6	13,2	13,0	-3,8	6,9	-1,4	6,2	8,7	4,3	19,8	3,6		
Странски директни инвестиции (во милиони ЕУР)	316,9	180,0	603,7	363,3	123,24	-8,6	-8,2	48,3	154,7	-42,4	23,7	15,2	-3,5	102,5	31,3	83,2	217,0	-16,4	16,5	24,5	24,6	60,7	50,4	86,1	197,1	435,2			
Надворешен долг																													
Бруто надворешен долг (во милиони ЕУР)	7.216,6	7.372,5	7.843,7	8.154,4	8295,5	8770,9	9068,8	8536,1	8.536,1				9.809,0				10.169,9				9.870,3								
јавен сектор	3.445,3	3.461,8	3.756,2	3.836,6	3816,5	4460,3	4644,4	4301,4	4.301,4				5.202,9				5.458,7				5.157,3								
јавен сектор/БДП (во %)	35,7	34,5	35,1	34,2	35,4	41,4	43,1	40,0	40,0				44,3				46,5				43,9								
приватен сектор	3.771,2	3.910,7	4.087,5	4.317,8	4478,9	4310,5	4424,1	4234,6	4.234,6				4.606,1				4.711,2				4.713,1								
Бруто надворешен долг/БДП (во %)	74,7	73,4	73,3	72,7	77,0	81,5	84,2	79,3	79,3				83,6				86,7				84,1								
Бруто девизни резерви (во милиони ЕУР) ^{/10}																													
	2.613,4	2.336,3	2.867,1	3.262,6	3.017,3	3.639,7	3.480,2	3.359,8	3.359,8	3.335,7	3.298,0	3.939,2	3.939,2	4.003,5	4.019,8	4.031,1	4.031,1	3.547,6	3.691,6	3.690,7	3.690,7	3.650,4	3.571,4	3.643,3	3.643,3	3.643,3	3.465,1	3.382,2	

Странска ефективна побарувачка
(годишни промени во %)




Извор: „Консензус форкаст“ и пресметки на НБРСМ.

Странска ефективна инфлација
(годишни стапки во %)



Извор: „Консензус форкаст“ и пресметки на НБРСМ.

Курс евро/САД-долар





Извор: „Консензус форкаст“ и пресметки на НБРСМ.

Kërkesa e huaj efektive e realizuar në vitin 2021 është 4,4% dhe është pak më e lartë se vlerësimet e tetorit (4,1%). Sa u përket pritshmërive për dy vitet e ardhshme, për vitin 2022 është bërë një korrigjim në rënie dhe rritja aktualisht pritet të jetë 3,7% (4,3% në tetor), ndërsa për vitin 2023 parashikohet një rritje prej 3% (më e lartë krahasuar me 2,3% në tetor). Rishikime të këtilla janë kryesisht rezultat i vlerësimeve për aktivitetin më të ulët ekonomik të Gjermanisë më 2022 dhe më të lartë më 2023⁶, krahasuar me vlerësimet e tetorit.

Sa i përket inflacionit të huaj efektiv, u bë një rishikim në rritje për të gjithë periudhën e projeksionit, veçanërisht për vitin 2022. Rritja e inflacionit të jashtëm në vitin 2022 dhe 2023 aktualisht pritet të jetë 3,6% dhe 2% në mënyrë përkatëse, kundrejt 2% dhe 1,7% gjithashtu në mënyrë përkatëse në tetor. Rishikimi në rritje vjen si pasojë e vlerësimeve për inflacion më të lartë në thuajse të gjithë partnerët tanë të importit, ku Gjermania dhe Bullgaria kanë mesatarisht kontributin më të madh pozitiv në rishikimin në rritje për dy vitet e fundit.

Sa i përket kursit valutor euro/USD, një rishikim më i rëndësishëm në rritje u bë për vitin 2022, me forcimin e mëtejshëm aktual të vlerës së dollarit amerikan ndaj euros. Ndryshimet e këtilla janë kryesisht një pasqyrim i përshkallëzimit të konfliktit ushtarak në Ukrainë dhe varësisë së lartë energjetike të Europës nga Rusia. Nga ana tjetër, për vitin 2023, korrigjimi është në kahe të rënies, ku pritet zhvlerësimi i mëtejshëm i dollarit amerikan në raport me euron.

⁶ Rritja e projektuar e Gjermanisë prej 3,5% dhe 2,7% në mënyrë përkatëse më 2022 dhe 2023, kundrejt 4,4% dhe 1,8%, gjithashtu në mënyrë përkatëse në tetor.



Rishikimet e çmimeve të ushqimit janë të ngjashme. Në fakt, sipas projeksioneve më të reja për vitin 2022, vlerësimet janë korrigjuar në rritje, ku tani pritet rritje më e theksuar e çmimit të grurit dhe rritje e çmimit të misrit, në vend të rënies. Lëvizjet në rritje të këtyre çmimeve janë

⁷ Për analizën e çmimeve të naftës, metaleve dhe produkteve ushqimore parësore përdoren raporte të ndryshme të FMN-së, Bankës Botërore, FAO, OPEC, BOE-së dhe portaleve të specializuara ekonomike ndërkombëtare.


Цени на пченицата и пченката во евра
(годишни промени во %)



Извор: ММФ и пресметки на НБРСМ.

kryesisht për shkak të rreziqeve në rritje të furnizimit më të ulët dhe ndërprerjeve në kanalet e furnizimit në Detin e Zi për shkak të konfliktit ushtarak midis Ukrainës dhe Rusisë⁸. Për vitin 2023, pritet aktualisht një rënie më e madhe e çmimeve të grurit dhe misrit, krahasuar me vlerësimet e tetorit.

Едномесечен Еурибор
(квартален просек, во %)




Извор: „Консензус форкаст“ и пресметки на НБРСМ.


Нë **EURIBOR-in njëmuor**, projeksionet janë të njëjta për vitin 2022 me ato të tetorit (-0,5%). Nga ana tjetër, një rishikim më i rëndësishëm në rritje është kryer për vitin 2023, me ç'rast pritet aktualisht që në gjysmën e dytë të vitit EURIBOR-i njëmuor të kalojë në zonën pozitive dhe mesatarisht për të gjithë vitin të jetë në 0,1%, kundrejt -0,4% në tetor. Lëvizjet e këtilla janë kryesisht për shkak të pritshmërive të investuesve për një shtrëngim gradual të politikës monetare nga BQE-ja, duke filluar nga fundi i këtij viti.

⁸ Ukraina dhe Federata Ruse së bashku përbëjnë rreth 30% të eksporteve globale të grurit. Porti i Odessës dhe Deti i Zi shërbejnë si kanalet kryesore për dërgesat ndërkombëtare të grurit nga Ukraina, ndërsa vendi është gjithashtu ndër eksportuesit kryesorë të elbit, misrit, lulediellit dhe farave të tjera vajore. Burimi: Publikimi i FAO: AMIS, Mars 2022.

Стапка на инфлација
(годишни придонеси во вкупната инфлација, во п.п.)



Придонеси кон годишната стапка на инфлацијата (во п.п.)



Në shkurt të vitit 2022, **çmimet e konsumit vendas** u rritën për 1% në bazë mujore (1,5% në muajin paraardhës), si rezultat i rritjes së çmimeve në të tre komponentët kryesorë. Çmimet e energjisë u rritën në shkurt për shkak të çmimeve më të larta të karburanteve, në përputhje me rritjen e çmimeve të derivateve të naftës në tregjet botërore, të lidhura kryesisht me tendosjet aktuale gjeopolitike me luftën ruso-ukrainase. Kontribut pozitiv kishin edhe rritja e çmimeve të ushqimeve⁹, me rritje më të theksuar të çmimeve të perimeve dhe kategorisë së çmimeve të “bukës dhe produkteve të drithërave”. Rritje të çmimeve në bazë mujore vihet re edhe në komponentin bazë të inflacionit, me rritje më të theksuar të çmimeve të duhanit¹⁰, aparaturave elektrike për higjienën personale, si dhe çmimet më të larta të transportit rrugor, ndërkaq ulja e çmimeve të transportit ajror ka një kontribut negativ.

Shkalla vjetore e inflacionit në shkurt është 7,6% (6,7% në janar), gjatë përshpejtimit të rritjes vjetore të çmimeve të energjisë dhe të komponentëve bazë. Kontributin më të rëndësishëm në shkallën vjetore të inflacionit e kanë rritja e çmimeve të karburanteve, perimeve të freskëta, bukës dhe produkteve të drithërave, si dhe rritja e çmimit të energjisë elektrike¹¹. Shkalla e inflacionit vjetor të realizuar në shkurt është mbi shkallën e projektuar nga cikli i projeksioneve të tetorit, me një zhvendosje në rritje në të tre kategoritë kryesore, por më i theksuar në komponentët energjetikë dhe ushqimorë.

Shkalla bazë e inflacionit në shkurt ishte 0,9% me bazë mujore (0,3% në muajin paraardhës). Në bazë vjetore, shkalla bazë e inflacionit është 4,3% (3,2% në muajin paraardhës), brenda së cilës kontributin më të lartë pozitiv e kanë çmimet e shërbimeve në restorante dhe hotele, të

⁹ Më 4 dhjetor 2021, Qeveria e RMV-së mori vendim për ngrirjen e çmimeve të produkteve ushqimore bazë (bukë, sheqer, miell, vaj luledielli ushqimor, qumësht, mish të freskët dhe produkte të mishit të thatë, djathë dhe gjizë) në nivelin e 1 dhjetorit. Më 14 dhjetor, lista e produkteve u zgjerua duke përfshirë çmimet e orizit, vezëve dhe makaronave. Vendimi për ngrirjen e çmimeve të produkteve ushqimore bazë nga fillimi i dhjetorit është i përkohshëm, i vlefshëm deri më 28 shkurt 2022 (në përputhje me vendimin shtesë të Qeverisë së RRMV-së, datë 28 janar 2022). Pavarësisht ngrirjes, sërish shohim rritje në kategorinë e përgjithshme ushqimore, kryesisht për shkak të rritjes së kategorive të tjera të produkteve që nuk mbulohen nga vendimi për ngrirjen e çmimeve.


¹⁰ Çmimet e shumicës së markave dhe llojeve të cigareve u rritën për 10 denarë që nga shkurti i vitit 2022, si pasojë e prirjes së rritjes së çmimeve të lëndëve të para, repromaterialeve dhe karburanteve, para së gjithash gazit dhe energjisë elektrike, të cilat kanë një pjesëmarrje të konsiderueshme në prodhim, si dhe për shkak të rritjes së rregullt vjetore të akcizës (çdo vit, duke filluar nga viti 2013 deri më 1 korrik 2023, akciza për cigare rritet për 0,20 denarë/copë).

¹¹ Sipas vendimit të Komisionit Rregullator të Energjetikës të RMV-së, datë 30.12.2021, çmimi i energjisë elektrike për furnizuesin universal “EVN HOME” SH. P. K Shkup nga 1 janari 2022 rritet për 9,48% (<https://www.erc.org.mk/pages.aspx?id=153>)

plotësuara nga çmimet e duhanit dhe në një masë të vogël, nga çmimet e produkteve të higjienës personale, pijeve joalkoolike, transportit ajror e rrugor, si dhe çmimet e automjeteve.

Sa u përket lëvizjeve të pritshme të çmimeve të supozimeve hyrëse të jashtëm në projeksionin e inflacionit, rishikimet janë në kahen në rënie, gjë që së bashku me realizimet më të larta sesa parashikimet, krijojnë rreze në rritje për shkallën e parashikuar të inflacionit në vitin 2022. Në të njëjtën kohë, vazhdojnë të jenë të theksuara pasiguria dhe dinamika e lëvizjes së çmimeve botërore të produkteve parësore në periudhën e ardhshme, e cila korrespondon me efektet e pasigurta ekonomike që lidhen me zhvillimin dhe trajtimin e pandemisë, kurse në periudhën e fundit ajo u theksua më tej nga konflikti ushtarak në Ukrainë dhe sanksionet e vendosura ndaj Rusisë nga shumica e vendeve të botës.

Инфлација и цени на храната и енергијата (годишни промени, во %)



Извор: Државен завод за статистика и пресметки на НБРСМ.

Странски ефективни* и домашни цени на храна (индекси, 2005 = 100)



* Ефективните странски цени на храна се добиени како пондериран збир од цените на храната во земјите што се најзначајни трговски партнери на Северна Македонија.
Извор: ДЗС, Еуростат и пресметки на НБРСМ.

Просечна исплатена плата
(годишни стапки, во %)




Извор: ДЗС.

Просечна исплатена месечна нето-плата по сектори
(номинални годишни стапки, во %)



Извор: ДЗС.

Бруто домашен производ
(реални годишни стапки, во %)



Извор: ДЗС и проекции на НБРСМ.

Разликите во серијата во остварениот период се должат на редовни ревизии на ДЗС.

Нë dhjetor të vitit 2021, rritja nominale vjetore e rrogës mesatare neto ishte 5,8% (5,6% në muajin paraardhës). Rritja e rrogës minimale për 1,7% në prill 2021, në përputhje me harmonizimin e rregullt ligjor, kontribuon pjesërisht për rritjen vjetore të rrogave ¹².

Rritje vjetore të rrogave në dhjetor ka në të gjitha aktivitetet, ndërsa më e theksuar vazhdon të jetë në aktivitetet që kanë të bëjnë me "transportin", "ndërtimin", "tregtinë", "veprimtaritë profesionale, shkencore dhe teknike", "veprimtaritë e shërbimit administrativ dhe ndihmës", kurse rritje solide shënuan edhe rrogat në "veprimtaritë që lidhen me pasuritë e paluajtshme", "veprimtaritë e shërbimeve të tjera" dhe "art, argëtim dhe rekreacion".

Me rritjen e shpenzimeve të jetesës në nivel vjetor, **rritja reale vjetore e rrogës neto në dhjetor ishte 0,9%.**

Rritja nominale dhe reale vjetore e rrogave e realizuar në tremujorin e katërt të vitit 2021 (5,3%, përkatësisht 0,7%) është më e ulët se sa pritej për këtë periudhë brenda projeksionit të tetorit.


Në tremujorin e katërt të 2021, PBB-ja realizoi një rritje reale prej 2,3% në bazë vjetore (3% në tremujorin e mëparshëm), që paraqet rritje të mëtejshme të ekonomisë vendase, por me dinamikë më të ngadaltë, në mes të përhapjes së valës së pestë të pandemisë që lidhet me llojin "omicron" të KOVID-19, ndërprerjen e zinxhirëve të furnizimit global dhe shfaqjen e efekteve të para të ndërprerjeve në tregun e energjisë.

Nga këndvështrimi i shpenzimeve të PBB-së, rritja në tremujorin e katërt i detyrohet tërësisht kontributit pozitiv të kërkesës vendase, në kushte rritjeje dhe të kontributit pozitiv në të gjitha kategoritë (investimet bruto, konsumi personal dhe konsumi publik). Nga ana tjetër, komponenti

¹² Në prill të vitit 2021 u bë harmonizimi i rregullt për rritjen e rrogës minimale (me rritjen për vitin paraardhës të rrogës mesatare të paguar në RMV, indeksit të shpenzimeve të jetesës dhe rritjes reale të PBB-së – përkatësisht një e treta e rritjes në secilin tregues). Në përputhje me njoftimin e Ministrisë së Punës dhe të Politikës Sociale, botuar në "Gazetën Zyrtare të RMV-së" nr. 80/21 për zbatimin e Ligjit të Rrogës Minimale në Republikën e Maqedonisë ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 11/12, 30/14, 180/14, 81/15, 129/15, 132/17 dhe 140/18 dhe "Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" nr. 124/19 dhe 239/19), rroga minimale neto u rrit për 260 denarë. Lartësia e rrogës minimale bruto, duke filluar nga prilli 2021 deri në mars 2022, është 22.146 denarë (më parë 21.776 denarë), përkatësisht rroga minimale neto është 15.194 denarë (më parë 14.934 denarë).

i eksportit neto shënoi një kontribut negativ, në kushtet e rritjes dukshëm më të fortë të importeve, krahasuar me rritjen e eksporteve.


Nga këndvështrimi prodhues i PBB-së, rritja në tremujorin e katërt i detyrohet kryesisht kontributit pozitiv të grupit të aktiviteteve të "tregtisë, transportit dhe hotelerisë", të cilat vitin e kaluar ishin një nga aktivitetet më të prekura nga kriza e shkaktuar nga Kovid-19. Një kontribut pozitiv shtesë kanë aktivitetet që lidhen me pasuritë e paluajtshme, si dhe aktivitetet e "informacionit dhe komunikimit", "administratës publike dhe mbrojtjes; arsimit; shëndetësisë dhe mbrojtjes sociale" dhe "veprimtaritë profesionale, shkencore dhe teknike; veprimtaritë e shërbimit administrativ dhe ndihmës". Nga ana tjetër, kontributin më të madh negativ e shënoi sektori i ndërtimit, ndërsa kontribut negativ kishte edhe industria, pjesërisht si pasojë e vështirësive në sektorin e automjeteve, si dhe në bujqësi.



Duke pasur parasysh sasinë e kufizuar të të dhënave në dispozicion, si dhe për shkak të përshkallëzimit ushtarak të tendosjeve gjeopolitike midis Rusisë dhe Ukrainës, është e vështirë të jepet një vlerësim i saktë i gjendjes së përgjithshme të ekonomisë në tremujorin e parë të vitit 2022. Kur bëhet fjalë për perceptimet e subjekteve ekonomike për gjendjen e ekonomisë¹³, rezultatet e sondazhit për periudhën janar-shkurt 2022 tregojnë për perceptime më të favorshme në raport me tremujorin e parë të vitit 2021, që përgjithësisht tregon vazhdimin e rritjes në këtë periudhë, megjithatë perceptimet janë disi më pak të favorshme në krahasim me tremujorin e mëparshëm, kryesisht lidhur me përhapjen e llojit "omicron", si dhe ndërprerjet në zinxhirët e furnizimit global dhe tregun e energjisë, të theksuara më tej pas konfliktit ushtarak ruso-ukrainas.

Sa u përket të dhënave me frekuencë të lartë në anën e ofertës, të dhënat e tregtisë dhe të industrisë janë në dispozicion për janarin e vitit 2022.

¹³ Ka të bëjë me sondazhet e kryera nga Komisioni European për të matur besimin ekonomik të subjekteve në një ekonomi. Treguesi i përbërë i besimit ekonomik përftohet si një mesatare e ponderuar e treguesve të besimit për konsumatorët dhe treguesve të besimit për sektorë individualë të ekonomisë (ndërtim, industri, tregti me pakicë dhe shërbime).




Нë janар, **qarkullimi në totalin e tregtisë** vazhdon të shënojë rritje reale të lartë me bazë vjetore prej 9,6% (10,4% në tremujorin paraardhës). Njëkohësisht, realizimet e favorshme në tregtinë totale i detyrohen rritjes së mëtejshme të lartë në tregtinë me shumicë dhe pakicë, ndërsa tregtia e automjeteve shënoi rënie të mëtejshme, por dukshëm më pak krahasuar me rënien në tremujorin paraardhës.

